Vendim nr. 279, datë 30.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (P) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PETËR SARAÇI,** përfaqësuar nga avokate Suela Mëneri, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 70 (86-2024-1585), datë 24.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-4787 (359), datë 25.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të të drejtave themelore të kërkuesit, në veçanti: a) së drejtës për proces të rregullt ligjor; b) së drejtës për mjet juridik efektiv; c) së drejtës së pronës; ç) si dhe mosrespektimit të detyrimit për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim, me detyrimin për respektimin e standardeve kushtetuese dhe konvencionale në shqyrtimin e saj.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 31, 71, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi (paditësi në procesin gjyqësor), në 1/6-ën pjesë, rezulton të jetë një nga trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësve R.S., P.S., G.S., A.S., L.S. dhe N.S., të cilëve, me vendimin nr. 16/1, datë 15.01.1993 (*vendimi nr. 16/1/1993*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Bashkia Shkodër, u është njohur e drejta e pronësisë, por për shkak se sipërfaqja prej 440 m^2 ishte e zënë me ndërtime shtetërore është vendosur kompensimi për këtë pasuri sipas parashikimeve të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

2. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të ndryshuar (*ligji nr. 133/2015*) Agjencia e Trajtimit të Pronës (*ATP*) (e paditura në procesin gjyqësor) ka bërë rivlerësimin e pronës dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 16, datë 30.05.2016, ka publikuar edhe vlerësimin për pasurinë prej 440 m² të njohur me vendimin nr. 16/1/1993 të KKKP-së, Bashkia Shkodër, në shumën 5.378.120 lekë (12.223 lekë/m²). Duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padi, me objekt anulimin e pjesshëm të aktit administrativ, vendimit të ATP-së, vetëm për vlerësimin e pronës së tij, si dhe detyrimin e organit administrativ (ATP-së) që t'i paguajë atij, si vlerë të pasurisë së shpronësuar, vlerën e drejtë të pronës sipas çmimit të tregut.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 70 (86-2024-1585), datë 24.07.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se vlerësimi financiar i kryer nga ATP-ja ishte në përputhje me ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sipas gjykatës së apelit, prona e njohur për kompensim duhet të vlerësohet sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit dhe, në rastin konkret, prona e njohur me vendimin nr. 16/1/1993 të KKKP-së, Bashkia Shkodër, kishte zërin kadastral "truall" dhe ky zë nuk kishte ndryshuar. Gjykata e apelit ka rrëzuar edhe pretendimin e kërkuesit për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve, që

ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna", duke arsyetuar se ai ishte shfuqizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", dhe se për vlerësimin financiar zbatohej vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" (*VKM-ja nr. 89/2016*), i miratuar në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, në kuptim të nenit 5, pika 54, të tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4787 (359), datë 25.09.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 70 (86-2024-1585), datë 24.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, duke e vlerësuar të drejtë atë për mënyrën sesi ka arsyetuar dhe disponuar. Po sipas Kolegjit Administrativ, VKM-ja nr. 89/2016 është e zbatueshme për vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim sipas parashikimeve të shprehura të ligjit nr.133/2015. Ai kolegj ka vlerësuar se qëndrimi i gjykatës së apelit për vlerën e kompensimit është në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për te drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe është dhënë në interpretim e në zbatim të vendimit në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, si dhe ka respektuar jurisprudencën kushtetuese në këtë drejtim. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, vlerësimi i gjykatës së apelit për vlerën e kompensimit, sikundër se paditësi nuk përfiton nga përmbajtja aktuale e dispozitave të ligjit nr. 133/2015, pas shtesave e ndryshimeve me ligjin nr. 77/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"" (*ligji nr. 77/2022*) është i drejtë, ndërkohë që gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje edhe të gjitha pretendimeve të ngritura përpara saj nga paditësi.

5. Në datën 05.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 25.05.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt* në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e juridiksionit zakonshëm nuk kanë shqyrtuar në mënyrë efektive dhe në themel pretendimin kryesor të ngritur prej tij, që kishte të bënte me ligjshmërinë e bazës normative mbi të cilën ATP-ja ka kryer vlerësimin

financiar. Kërkuesi ka argumentuar përpara gjykatës së apelit se kontrolli i ligjshmërisë së VKM-së nr. 89/2016 duhej të kryhej nëpërmjet gjykimit incidental, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*ligji nr. 49/2012*), por ajo nuk është marrë në konsideratë nga gjykata e apelit. Edhe Kolegji Administrativ nuk e ka korrigjuar këtë mangësi të gjykatës së apelit dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për ushtrimin e kontrollit incidental të normës. Arsyetimet e gjykatave janë formale, pasi nuk trajtojnë lidhjen ndërmjet pretendimit të ngritur nga kërkuesi dhe pasojës konkrete që ai kishte në të drejtën për kompensim. Gjykatat nuk kanë analizuar nëse përdorimi i VKM-së nr. 89/2016 në rastin e kërkuesit ishte i pajtueshëm me standardin "shpërblim i drejtë".

6.1.2. *Së drejtës për një mjet juridik efektiv,* për shkak se gjykatat kanë refuzuar ushtrimin e kontrollit incidental për ligjshmërinë e aktit nënligjor që kanë shërbyer si bazë për nxjerrjen e aktit administrativ individual që e prek drejtpërdrejt kërkuesin. Ai nuk kishte në dispozicion një mjet të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar VKM-në nr. 89/2016, si akt nënligjor normativ me efekt të përgjithshëm, për shkak të kufizimeve procedurale të legjitimimit aktiv, ndaj mjeti i vetëm efektiv për mbrojtjen e të drejtave ishte gjykimi incidental në kuadër të kundërshtimit të aktit administrativ individual të ATP-së, që është nxjerrë në zbatim të kësaj VKM-je. Gjykatat nuk kanë analizuar nëse VKM-ja nr. 89/2016 ishte në përputhje me ligjin nr. 133/2015 dhe me standardet e KEDNJ-së në kontekstin konkret të çështjes, për rrjedhojë nuk kanë verifikuar nëse akti individual i ATP-së ishte nxjerrë mbi një bazë të ligjshme.

6.1.3. *Gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin material,* konkretisht ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore, në një mënyrë që ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta në të drejtën e pronës së kërkuesit. Ato e kanë ndërtuar arsyetimin mbi një interpretim të ngushtë dhe formal të ligjit nr. 133/2015, pa marrë në konsideratë qëllimin e tij, kontekstin kushtetues dhe standardet konventore. Gjykatat janë fokusuar në dispozitën që parashikon përdorimin e hartës së vlerës në fuqi në momentin e hyrjes së ligjit në fuqi, duke nxjerrë nga ky interpretim përfundimin se VKM-ja nr. 89/2016 duhej të zbatohej automatikisht për vlerësimin financiar. Ky interpretim ka cenuar standardin kushtetues dhe

konventor të “shpërblimit të drejtë”, çka e bën ndërhyrjen në të drejtën e pronës disproporcionale.

6.2. *E drejta e pronës private*, për shkak se kompensimi nuk reflekton standardin “shpërblim i drejtë”. Kërkuesi ka kundërshtuar vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja, pasi vlera e përcaktuar mbi bazën e VKM-së nr. 89/2016 është dukshëm më e ulët se ajo që do të rezultonte sipas hartës së vlerës së vitit 2008, e përdorur në mënyrë të qëndrueshme në jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së për çështjet ndaj shtetit shqiptar. Konkretisht, çmimi 12.223 lekë/m² i aplikuar në vitin 2016 është ndjeshëm më i ulët se ai 24.000 lekë/m² sipas hartës së vitit 2008, duke krijuar një diferencë që kërkonte domosdoshmërisht verifikim gjyqësor në raport me standardin “shpërblim i drejtë”. Gjykatat u mjaftuan me konstatimin se VKM-ja nr. 89/2016 ishte akti i zbatueshëm në kohën e vlerësimit ndërkohë që duhej të verifikonin nëse ulja e vlerës kishte një bazë objektive, nëse reflektonte realisht tregun dhe nëse ruante një raport të arsyeshëm midis interesit publik dhe së drejtës individuale të kërkuesit. Gjykatat nuk analizuan nëse çmimi sipas VKM-së nr. 89/2016 reflektonte realisht vlerën e tregut për pronën e kërkuesit, nuk shqyrtuan nëse diferenca me hartën e vitit 2008 ishte e justifikuar dhe as nëse shuma përfundimtare e kompensimit ruante balancën e drejtë që kërkon neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

6.3. *Gjykatat nuk kanë respektuar dhe zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së*, pasi arsyetimi se ajo gjykatë nuk ka trajtuar drejtpërdrejt papajtueshmërinë e hartave të vlerës ose të metodologjive përkatëse me KEDNJ-në, ka kufizuar rolin e kësaj jurisprudence në një nivel deklarativ. Ky arsyetim shmang thelbin e standardit të vendosur nga GJEDNJ-ja, i cili nuk kërkon domosdoshmërisht një deklarim të drejtpërdrejtë mbi çdo akt konkret, por vendos parime të përgjithshme që duhet të zbatohen nga autoritetet vendase në raste individuale. As Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në mënyrë konkrete mënyrën sesi standardet e GJEDNJ-së duhej të zbatoheshin në rastin e kërkuesit, duke munguar vlerësimi për detyrimin e gjykatave për të verifikuar nëse mekanizmi i përdorur garanton balancën e drejtë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1,

shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare. Për rrjedhojë, në rastin konkret, Kolegji do të analizojë vetëm kriterin e legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesit.

16. Kërkuesi ka pretenduar *cenimin e së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *së drejtës për mjet juridik efektiv,* për shkak se gjykatat kanë refuzuar ushtrimin e kontrollit incidental për ligjshmërinë e aktit nënligjor, VKM-së nr. 89/2016, që ka shërbyer si bazë për nxjerrjen e aktit administrativ individual që e prek drejtpërdrejt kërkuesin. Sipas tij, ai nuk kishte në dispozicion një mjet të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar VKM-në nr. 89/2016, si akt nënligjor normativ me efekt të përgjithshëm, për shkak të kufizimeve procedurale të legjitimimit aktiv, ndaj mjeti i vetëm efektiv për ishte gjykimi incidental, kërkesë që nuk është pranua nga Gjykata Administrative e Apelit dhe kjo shkelje nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë.

17. Kolegji vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, ka kërkuar edhe vënien në lëvizje të kontrollit incidental për kontrollin e VKM-së nr. 89/2016, sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, mund të vendosë të mos zbatojë aktin nënligjor mbi të cilin është bazuar veprimi administrativ objekt gjykimi, kur çmon se ai akt është i paligjshëm. Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata e apelit, në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të saj dhe përmbajtjes së nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, e ka vlerësuar të pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka parashtruar dhe nuk ka argumentuar konkretisht se me cilën dispozitë ligjore konkrete bie në kundërshtim

VKM-ja nr. 89/2016 dhe as se cilat janë elementet që, sipas pikave 3 dhe 4 të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, tregojnë paligjshmërinë e këtij akti nënligjor normativ. Në vlerësimin e Kolegjit, ky arsyetim i gjykatës së apelit jo vetëm që i ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesit, por ai nuk rezulton të jetë bazuar në ndonjë interpretim ose zbatim haptazi arbitrar të ligjit material të zbatueshëm, pra që të bjerë ndesh me vetë thelbin e së drejtë për një proces të drejtë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

18. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit* edhe për shkak se arsyetimet e gjykatave janë formale, pasi nuk kanë analizuar nëse zbatimi i vlerës së kompensimit, sipas VKM-së nr. 89/2016, ishte i pajtueshëm me standardin "shpërblim i drejtë". Sipas tij, gjykatat *kanë zbatuar gabim ligjin material,* konkretisht ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore, duke cenuar standardin "shpërblim të drejtë", çka e bën ndërhyrjen disproporcionale. Po sipas kërkuesit, për shkak se kompensimi nuk reflekton standardin "shpërblim i drejtë" është cenuar edhe *e drejta e pronës private*, pasi vlera e përcaktuar mbi bazën e VKM-së nr. 89/2016 (12.223 lekë/m²) është dukshëm më e ulët se ajo që do të rezultonte sipas hartës së vlerës së vitit 2008 (24.000 lekë/m²), e përdorur në mënyrë të qëndrueshme në jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së për çështjet ndaj shtetit shqiptar. Gjykatat, vijon kërkuesi, nuk kanë analizuar nëse çmimi sipas VKM-së nr. 89/2016 reflektonte realisht vlerën e tregut për pronën e tij dhe në këtë drejtim ai ka ngritur pretendime edhe për *mosrespektimin dhe zbatimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së* lidhur me respektimin e mekanizmit që garanton balancën e drejtë.

19. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i përket konceptit kushtetues "shpërblim të drejtë" në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, që lejon shpronësimin ose kufizimet e së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, Gjykata e ka interpretuar, në kuptim edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe

respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Gjykata ka theksuar se shpërblimi ose kompensimi në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Skema e kompensimit të pronave sipas ligjit nr. 133/2015 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i është nënshtruar si kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata, ashtu edhe kontrollit të respektimit të të drejtave konventore nga GJEDNJ-ja, të cilat e kanë gjetur atë në pajtim me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Po kështu, ato kanë vlerësuar se me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar *(shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se prona e kërkuesit nuk ka pasur ndryshime të zërit kadastral që në kohën e shpronësimit të saj dhe se pretendimet e tij kanë të bëjnë me masën e vlerësimit të saj për kompensim, pra me hartën e zbatueshme të vlerës së pronës. Pasi është ndalur fillimisht në konstatimin lidhur me zërin kadastral të zbatueshëm, ai "truall", Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se vlerësimi financiar i kryer nga ATP-ja ishte në përputhje me ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sipas asaj gjykate, pretendimi i kërkuesit për zbatimin e VKM-së nr. 1620/2008 është i pabazuar, pasi ky akt ishte shfuqizuar me VKM-në nr. 514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", dhe se për vlerësimin financiar zbatohej vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 89/2016, si akti i miratuar në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, në kuptim të nenit 5, pika 54, të tij. Po sipas gjykatës së apelit, referuar aktit të ekspertimit dhe dokumentacionit hartografik për zonën kadastrale në të cilën ndodhet aktualisht prona e njohur me vendimin nr. 16/1/1993 të KKKP-së, Bashkia Shkodër, ka vlerësuar se vlera për tokën truall është në shumën 12.223 lekë/m^2, ndaj vlerësimi financiar për sipërfaqen për të cilën është njohur e drejta e kompensimit të kërkuesit përllogaritet sipas formulës: 440 m^2 x 12.223 lekë/m^2 = 5.378.120 lekë. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se edhe vlera prej 10 % e kësaj shume është në masën 537.812 lekë dhe paditësi nuk përfiton nga përmbajtja aktuale e dispozitave të ligjit nr.133/2015, pas shtesave dhe ndryshimeve me ligjin nr. 77/2022.

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke e vlerësuar

atë të bazuar në ligj dhe në prova. Ai kolegj e ka gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së apelit lidhur me pretendimet për VKM-së nr. 89/2016, duke vlerësuar se ky akt është i zbatueshëm për vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim sipas parashikimeve të shprehura të ligjit nr.133/2015. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se qëndrimi i gjykatës së apelit për vlerën e kompensimit është në përputhje edhe me praktikën kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së, referuar pragut minimal prej 10% të vlerës së kompensimit, duke e gjetur të drejtë edhe qëndrimin se paditësi nuk përfiton nga përmbajtja aktuale e dispozitave të ligjit nr. 133/2015, pas shtesave e ndryshimeve me ligjin nr. 77/2002.

23. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të kërkuesit për mënyrën dhe formën e kompensimit të pronës, referuar zërit kadastral të saj dhe vlerës së pronës sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke u shprehur edhe në lidhje me standardin e pragut minimal të kompensimit që garanton shpërblimin në një masë jo më të ulët se 10%. Për rrjedhojë, gjykata e apelit, në përputhje me kompetencat e saj dhe në kuptim të legjislacionit të zbatueshëm për trajtimin e kërkesave për kompensimin e pronave ish-pronarëve, ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për vlerësimin e kryer nga ATP-ja për pronën e tij, duke i kthyer atij përgjigje të arsyetuar në këtë drejtim. Edhe pse kërkuesi ka pretenduar se harta e vlerësimit sipas VKM-së nr. 89/2016 nuk pasqyron vlerat e tregut të pronave, kriteri kushtetues është ai i shpërblimit të drejtë dhe jo i shpërblimit të plotë të pronës së njohur për kompensim, plotësimi i të cilit, sipas Gjykatës, nuk vihet në dyshim nga zbatimi i VKM-së nr. 89/2016 (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi, i ka gjetur ato të pabazuara dhe të pamjaftueshme për të cenuar vendimin e gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe argumentet mbi të cilat ka mbështetur qëndrimin e saj.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara nuk rezulton ndonjë interpretim ose zbatim haptazi arbitrar i ligjit material ose procedural, në atë masë sa gabimi i pretenduar të mos mbetet më në planin e ligjshmërisë, por të marrë natyrë kushtetuese dhe ta bëjë procesin në tërësi të padrejtë. Për më tepër, në këtë drejtim, Kolegji thekson se çështjet e rivlerësimit të provave e përcaktimit të fuqisë së tyre provuese dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve për zbatimin e ligjit, për sa kohë nuk shfaqin arbitraritet të dukshëm, ose cenim të garancive kushtetuese, u përkasin gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.